



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1587/Prot.
4

Tiranë, më 6/12/2013

REKOMANDIM

Nr 49, datë 06/12/2013

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organizative dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Mektrin Motors" sh.p.k, Durrës.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhërit nr.237 datë 07.11.2013 u ushtrua kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Mektrin motors" sh.p.k, Durrës, me objekt:

- Masat lidhur me sigurinë e të dhënave personale (neni 27).

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale pasi shqyrtoi procesverbalin e kontrollit administrativ, si dhe provat e administruara vëren se:

Kontrolluesi nuk ka hartuar rregulla lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale. Kontrolluesi nuk ka në fuqi një rregullore të veçantë për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe mbrojtjen e të dhënave personale, sipas kërkesave të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale vlerëson se hartimi i rregulloreve është një pjesë e rëndësishme e masave të sigurisë që në tërësi zbaton kontrolluesi, prandaj është shumë e rëndësishme që ju si kontrollues të hartoni rregullore të veçantë për të përcaktuar rregulla për mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale. Në rregullore duhet të përcaktohen detyrat e punonjësve, të drejtat e tyre, aksesit etj, si dhe rregulla lidhur me konfidencialitetin e të dhënave personale. Përmirësimi dhe plotësimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale mungesën e marrjes së këtyre masave e konsideron shkelje të nenit 27 pika I të ligjit nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar ... "Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të

paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi”.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative ;

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të nenit 27/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar :
 - Të hartohet rregullore e veçantë lidhur me mënyrën e mbledhjes, përpunimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.
 - Në faqen tuaj në internet duhet të publikohen “politikat e privatësisë” (paketë rregullash) me qëllim informimin e personave që vizitojnë faqen mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale/sensitive, masat e sigurisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë. Politikat e privatësisë synojnë sensibilizimin e publikut mbi rëndësinë e mbrojtjes së privatësisë dhe të drejtat që gëzojnë në këtë fushë.
2. Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes në dijeni të këtij Rekomandimi.
3. Për plotësimin e këtij detyrimi të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
4. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, sipas të cilit... “Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues,veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave”.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

FLORA ÇABEJ (POGAÇE)

